



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

# Buletini

Publikim  
dymujor  
Viti X  
Nr.61  
Korrik - Gusht  
2013

## Këshilli i Kryetarëve debaton pagat e zyrtarëve komunal me Ministrin e Administratës Publike



Asociacioni i Komunave të Kosovës organizoi takim të rradhës të Këshillit të Kryetarëve, e ku mori pjesë edhe ministri i Ministrisë së Administratës Publike z. Mahir Jaghillar lidhur me diskutimet për projektligjin për Pagat e Funkionarëve Publik në nivel të Kosovës.



**Financat  
Komunale –  
Program  
mësimor për  
Qeveritë Lokale**

**Video-regjistrime  
lidhur me projektet  
e kryera nëpër  
komuna**

## Punëtori me Kryesinë e Kolegjumit të Zyrtarëve për Integritet Evropian

Asociacioni i Komunave të Kosovës më datë 5-7 korrik 2013 në Durrës organizoi punëtorinë dy-ditore të Kryesisë së Kolegjumit të zyrtarëve për integritet evropian.

## Këshilli i Kryetarëve debaton pagat e zyrtarëve komunal me Ministrin e Administratës Publike

Asociacioni i Komunave të Kosovës organizoi takim të rradhës të Këshillit të Kryetarëve, e ku mori pjesë edhe ministri i Ministrisë së Administratës Publike z.Mahir Jagxhillar lidhur me diskutimet për projektligjin për Pagat e Funkionarëve Publik në nivel të Kosovës.



**Z.Mahir Jagxhillar - Ministër i Ministrisë së Administratës Publike tha se qëllimi është që të bëhet një rend dhe raport mes pagës së personelit në institucione krahas pozitës së tyre.**



**Z.Qemajl Ahmeti - Anëtar i Bordit të AKK-së dhe kryetar i komunës së Gjilanit tha se thjeshtë duhet të marrim gjitha kërkesat reale dhe në fund të nxjerrim një ligj për trajtim me dinjitet për pozitë dhe përgjegjësitë e tyre.**

Z.Qemajl Ahmeti - Anëtar i Bordit të AKK-së dhe kryetar i komunës së Gjilanit duke folur në emër të Asociacionit të Komunave të Kosovës tha se Bordi i AKK-së ka kohë që po merret me këtë çështje, dhe në këtë proces ne nuk kërkojmë komoditet por plotësimin e nevojave të punëtorëve komunal në nivele të ndryshme me qëllim që njerëzit me qenë të motivuar dhe më të efektshëm përmes një page të dinjitetshme. Diferencat janë të mëdha dhe jo normale në pushtetin lokal për kryetarin, drejtorët komunal dhe këshilltarët. Poashtu mes drejtorit të shkollës dhe mësuesit prandaj nuk kemi cilësi të dëshiruara për pozitën e drejtorit e që ka shumë përgjegjësi. Ne vetëm kërkojmë që të ketë trajtim të dinjitetshëm dhe proporcional me pozitën. Poashtu duhet të dihet se më lehtë bëhesh deputet sesa kryetar komune. Nuk mund të barazohet kryetari i Prizrenit me atë të një komune të vogël për shembull. Thjeshtë duhet të marrim gjitha kërkesat reale dhe në fund të nxjerrim një ligj për trajtim me dinjitet për pozitë dhe përgjegjësitë e tyre.

Z.Mahir Jagxhillar - Ministër i Ministrisë së Administratës Publike tha se qëllimi është që të bëhet një rend dhe raport mes pagës së personelit në institucione krahas pozitës së tyre. Poashtu ky ligj sqaron pagën e plotë dhe jo të plotë. Sistemi i pagës në institucione në nivel vendi mund të rregullohet me një ligj tjetër kurse ne sot punojmë vetëm për një ligj për pagën e të zgjedhurve dhe administratës publike. A ka mundësi për dy paga apo një pagë e gjysmë, ose vetëm një pagë bazë e tjetra në një përqindje të caktuar do ta shohim në të ardhmen. Por mos të harrojmë se kemi edhe kufizime, ku nuk lejohet të tejkalohet një shumë e caktuar për paga derisa paga duhet të bëhet vetëm sipas meritës. Besoj se në fillim të mandatit të ardhshëm të

filloj implementimi i këtij ligji dhe të mos zvogëlohen pagat. Por ende kemi mundësi të fusim propozime të reja në këtë ligj, dhe jemi të hapur për bashkëpunim. Ne e dimë se ka debalancë mes pagave edhe me ligjet tjera dhe do të ishte e dobishme harmonizimi me tabelat e tjera.

Z. Sazan Ibrahim - Drejtor Ekzekutiv i AKK-së paraqiti listën e koeficientëve sipas vlerësimeve të Këshillit të Kryetarëve ku qëllimi i kësaj liste nuk është çështje e të hollave apo lartësisë së pagës por edhe çështje e imazhit dhe nivelit të përfaqësimit që nga kryetari, drejtori apo këshilltari komunal.



Z.Agron Kuci - Kryetar i Komunës së Junikut tha se përfaqësimi i qytetarëve si kryetar komune duhet të ketë më shumë respekt e meritë edhe me pagë poashtu edhe për këshilltarët dhe drejtorët komunal. Për mendimin tim Ministria e Administratës Publike ska qenë e përkushtuar të bëj zgjidhje në këtë drejtim. Ka mungesë të tepërt për pozitën e kryetarit të komunës sepse unë vij si kryetar komune në mbledhje qeverie me veturë zyrtare e as parking nuk kam të drejtë të shfrytëzoj në institucionet qendrore. Përfundimisht ky ligj është nënçmues dhe diskriminues.

Z.Avni Kastrati - Kryetar i Komunës së Mitrovicës tha se -

unë mendoj se ligji duhet të ketë dy tabela për paga, një për nivel republike ndërsa tjetra për komunat me specifikat e tyre. Kryetari i komunës në harmoni me përgjegjësitë që ka para qytetarëve duhet të ketë një pagë me meritore poashtu edhe drejtorët komunal dhe anëtarët e Kuvendit Komunal.

Z.Nexhat Demaku - Kryetar i Komunës së Drenasit - potencoi se ky ligj nuk guxon të krijoj konflikt se kush e ka pagën më të madhe e kush jo në raport me kryetarin e komunës. Sa i përket limitimit për pagesat për paga, duhet të jemi me fleksibël dhe të mos kemi nëpër ministri nga 3-4 zëvendësministra apo kabinetet

me numër të madh të anëtarëve, pra zvogëlime të ketë edhe në nivelin qendror jo vetëm nëpër komuna. Duhet përfundimisht të kuptohet se kryetarët e komunave nuk kërkojnë paga të larta por të dinjitetshme në raport me përgjegjësitë.

Z.Sami Istrefi - nga komuna e Vushtrrisë - kërkoi që të nxjerrim ligje që kanë qëndrueshmëri të madhe. Ai shtroi çështjen se çka ndodh me rregulloren e komunës së Gjilanit për ish-zyrtarët komunal pas miratimit të këtij ligji. Duhet ta keni të qartë edhe se nëse ministrat do të kishin pagë më të vogël se kryetar ne do të reagonim për shkak të imazhit dhe pozitës.



## Trajnimi në udhëheqjen arsimore

Në Qershor-Korrik 2013, Drejtorët Komunal të Arsimit të Komunave të Kosovës, pjesëmarrës të trajnimit në Udhëheqjen Arsimore mbështetur nga Programi i GIZ-CDBE kanë përfunduar tre modulet e trajnimit: 1. Menaxhimi i Projekteve, 2. Komunikimi dhe Bashkëpunimi, 3. Menaxhimi efektive dhe moderimi i takimeve, të cilat ishin pjesë e ciklit trajnues që përbëhej nga shtatë module që mbulojnë të gjitha fushat përkatëse të menaxhimit të shkollës dhe udhëheqjes në kontekst të decentralizimit dhe autonomisë së shkollës, module të tilla si (a) arsimim cilësor, (b) një shkollë e mirë, (c) zhvillimi i planit të shkollës, (d) menaxhimi i projektit, (e) komunikimi dhe bashkëpunimi, (f) udhëheqja dhe menaxhimi i personelit (g) menaxhimi efektiv dhe udhëheqja e takimeve. Katër modulet e trajnimit: a) cilësia e arsimit, (b) një shkollë e mirë, (c) zhvillimi i planit të shkollës (f) udhëheqja dhe menaxhimi i personelit u mbajtën në vitin 2012. Trajnimi është zhvilluar dhe testuar nga GIZ dhe akredituar nga Ministria e Arsimit. "

## Financat Komunale – Program mësimor për Qeveritë Lokale



**E-Instituti i Bankes Botërore ofron një kurs të ri të mësimin në distancë për financat komunale.**

Ky kurs do të përmirësojë njohuritë dhe aftësitë e qeverive lokale, veçanërisht në qytetet e mesme dhe të mëdha, për financat komunale, duke përfshirë matjen e performancës, menaxhimi i të hyrave dhe të dalave, mjetet dhe shërbimet lokale dhe mobilizimi i

burimeve të jashtme. Trajnimi do të fokusohet në perspektivën e qeverisjeve lokale dhe do të sigurojë mjete e instrumente se si të përmirësojë menaxhimin dhe transparencën e financave lokale. Kursi është falas. Kursi do të implementohet nga Shtatori deri në Dhjetor të vitit 2013 dhe afati i aplikimit ishte 25 Gusht 2013. Afati për aplikim për implementimin e dytë është 24 Shkurt 2014.

Për më shumë informacione: <http://einstitute.worldbank.org/ei/course/municipal-finance-learning-program-local-governments>

## Video-regjistrime lidhur me projektet e kryera nëpër komuna

Që nga viti 2007 projekti Zvicër – Kosovë Përkrahja për Qeverisje Lokale dhe Decentralizim (LOGOS) si pjesë e programit shtetëror të Agjencisë Zvicëre për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në Kosovë - ka forcuar qeverisjen lokale dhe reformat e decentralizimit në nëntë komuna në juglindje të Kosovës. LOGOS-i ka kryer një video-regjistrim lidhur me ndërhyrjet e kryera nëpër komuna.

Në pesë muajt e fundit këto regjistrime janë plotësuar me intervistat që janë bërë me akterët kyç në fushën e qeverisjes lokale. Ky material është edituar në tetë video raporte. Çdo video raport mbulon një fushë tematike



që LOGOS-i ka punuar, siç janë: planifikimi strategjik dhe hapësinorë, transparenca në buxhetet komunale, tatimi në pronë, zyrat pritëse, pjesëmarrja e qytetarëve, menaxhimi i mbeturinave, investimet kapitale në komuna dhe barazia gjinore në planet dhe buxhetet komunale. Video raportet përshkruajnë problemin, intervenimet dhe

rezultatet. Stafi komunal, politikanët vendorë, ekspertët tematik dhe qytetarët japin mendimin e tyre. Gjatë 15 minutave sa zgjat një video raport, ofrohet një përshtypje e reformave që LOGOS-i ka mbështetur. Të gjitha videot mund t'i gjeni në kanalën YouTube të LOGOS-it: <http://www.youtube.com/user/helvetaslogos>

## Ndërroi jetë Drejtori i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Istogut, Qazim Loxha

Me 29.08.2013, pas një sëmundje të rëndë, ndërroi jetë Qazim Loxha-Drejtor në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim.

Që nga konstituimi i organeve komunale pas luftës i ndjeri Qazim Loxha ka qenë i zgjedhur Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi, Zhvillim dhe Rindërtim. Ai me punën e tij të pa lodhshme kontribuoi në themelimin dhe funksionimin e organeve komunale si dhe në rindërtimin e komunës së Istogut që nga lufta doli shumë e shkatërruar.



Qazim Loxha ishte dhe mbetet figurë e respektuar nga kolegët dhe qytetarët e Komunës së Istogut dhe më gjerë.

Asociacioni i Komunave të Kosovës vlerëson lartë punën dhe angazhimin e drejtorit Qazim Loxha edhe në Kolegjin e Drejtorëve Komunal për Buxhet dhe Financa të Komunave të Kosovës në kuadër të AKK-së ku kontributi i tij ishte madhor për sistemin financiar të pushtetit lokal.

### Rishikohet Drafti i Strategjisë së Kolegjiut për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Asociacioni i Komunave të Kosovës ka mbajtur punëtorinë dy-ditore me Kryesinë e Kolegjiut të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, për rishikimin e draftit të parë të Strategjisë së Kolegjiut për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për tri vitet në vijim 2013-2016. Strategjia do të paraqitet edhe në takimin e radhës së Kolegjiut të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, për të ndjekur procesin e finalizimit dhe gjithëpërfshirjes si udhërrëfyes i punës së këtij Kolegjiut në kuadër të AKK-së.

### Punëtori me Kryesinë e Kolegjiut të Zyrtarëve për Integritime Evropiane

Asociacioni i Komunave të Kosovës më datë 5-7 korrik 2013 në Durrës organizoi punëtorinë dy-ditore të Kryesisë së Kolegjiut të zyrtarëve për integritime evropiane.

Në këtë punëtori morën pjesë zyrtarë komunal për integritime evropiane në bashkëpunim me ekspertin e kësaj fushe si dhe përfaqësuesit e AKK-së, me qëllim diskutimin dhe mbështetjen e procesit në hartimin e Planit Strategjik të Kolegjiut për Integritime Evropiane si dhe avancimin e mëtutjeshëm të aktiviteteve të Kolegjiut në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Nisur nga nevoja për fuqizimin e rolit të KIE dhe rrjedhimisht të komunave në ushtrimin e autorizimeve ligjore dhe kryerjen e obligimeve që dalin nga PVNMSA, (Plani i Veprimit për negociimin e marrëveshjes për Stabilizim Asocim) është shfaqur ideja për hartimin e një Planit Strategjik të Kolegjiut për Integritim Evropian (PSKIE).

Marrë parasysh se me avancimin e procesit të integritimit evropian përsa për rrolin e komunave do të jetë në ngritje e sipër, është menduar se PSKIE duhet të parasheh objektivat dhe aktivitetet për periudhën pesë vjeçare 2014-2018, por e cila do duhej të rishikohej në periudha vjetore në frymën e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) që pritet të nënshkruhet në 2014.

## Shkurtimisht

- 29 korrik 2013 - AKK-ja mori pjesë në takimin përfundimtar që organizoi projekti i USAID-it DEMI, të cilët prezentuan punën e tyre dhe rezultatet që i kanë arritur për kohën sa kanë punuar. Po ashtu falënderuan AKK-në si partner që bashkëpunuar për t'ju ndihmuar komunave të Kosovës.
- AKK-ja me mekanizmat e saj profesional po harton Strategjitë e Kolegjiumeve 2014-2017.
- AKK-ja po merr pjesë në takimet e rregullat të Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale e Familjare, ku po hartohen Udhëzimet Administrative për licencimime ofruesve të Shërbimeve Sociale për disa kategori.
- Me 10 dhe 11 Korrik 2013 ne Prishtinë, në qendrën e trajnimit në SHMP Shtjefën Gjeçovi DKA-të mbajten punëtorinë trajnuese në Udhëheqjen arsimore moduli: Komunikimi dhe bashkëpunimi.

## Lajme nga Komunitat

### Prishtinë: Aprovohen dy dokumentet strategjike, PZHK dhe Strategjia e Zhvillimit lokal ekonomik



Kuvendi i Komunës së Prishtinës me shumicë absolute të votave ka aprovuar Planin Zhvillimor të Komunës për periudhën 2013-2022+, si dhe Strategjinë e Zhvillimit lokal ekonomik të Komunës së Prishtinës, për periudhën 2013-2016, dokumento këto strategjike për zhvillimin e qytetit të Prishtinës. Në lidhje me këtë, kryetari i Prishtinës, dr. Isa Mustafa tha se ky dokument (PZHK) i rëndësishëm që i mbron interesa e komunës dhe hap perspektivën e zhvillimit të qytetit të Prishtinës. Kryetari Mustafa tha se ky dokument gjatë fazës së hartimit është diskutuar me të gjitha shtresat e shoqërisë, qytetarët, partitë politike dhe organizatat e ndryshme joqeveritare.

Ndryshe, PZHK paraqet profilin e gjendjes në komunën e Prishtinës, pozita, rëndësia dhe çështjet tjera specifike të territorit të komunës së Prishtinës, në kontest me Planin hapësinor të Kosovës, analizën e profilit me të cilën tregohen përparësitë, mangësitë dhe mundësitë e zhvillimit të komunës së Prishtinës, si dhe vlerësimet e ndikimit socio-ekonomik dhe mjedisor në këto zhvillime.

Përmbajtja e vizionit dhe parimeve paraqet të ardhmen e komunës së Prishtinës, caqet dhe prioritetet strategjike zhvillimore afatgjate.

Korniza e zhvillimit hapësinor komunal përmban strukturën dhe lokacionin hapësinor për zhvillimin dhe organizimin e ardhshëm ekonomik: regjenerimit, turizmit, rekreacionit, tregtisë,

transportit komunal, popullsisë, banimit, vendbanimeve, çështjeve sociale, trashëgimisë kulturore, mjedisit, duke përfshirë trashëgiminë natyrore, shënimin e zonës urbane ekzistuese dhe zgjerimet e propozuara për të ardhmen, si dhe ndërtimin jashtë zonës urbane dhe zonave ndërtimore të fshatrave.

Pjesa e zbatimit të Planit përbën, kushtet e rëndësishme për zhvillimin dhe shfrytëzimin e tokës në komunë, destinimin e sipërfaqeve, zonat ndërtimore për vendbanime dhe strukturat ekzistuese jashtë zonave të vendbanimeve, kushtet për vendosjen e korridoreve apo traseve dhe sistemeve të tjera të infrastrukturës dhe masat për parandalimin e ndikimeve negative në mjedis.

Gjatë hartimit të këtij Plani, puna e konzorciumit në raport me Drejtorinë, stafin mbikëqyrës dhe menaxherët e projekt është zhvilluar kryesisht në punëtori, të cilat janë mbajtur në vazhdimësi.

### Suharekë: Ekspozita e prodhimeve vendore në bujqësi



Prodhuet të prodhimeve vendore në bujqësi kanë ekspozuar prodhimet e tyre në festën e diasporës "Diafesti 2013". Prodhimet si në agroindustri, pije alkoolike, jo alkoolike, perime, mjaltë dhe të tjera i kanë vizituar shumë qytetarë si dhe udhëheqës tjerë komunal. Kryetari i komunës Blerim Kuçi, fermerëve që kanë ekspozuar prodhimet e tyre u ka shprehë përgëzime dhe i ka uruar për sukseset e arritura në lëminë e bujqësisë.

## Lajme nga Komunat

### Podujevë: Fermerët përfitojnë sistemin e ujitjes nga komuna



Kryetari i Komunës së Podujevës, z.Agim Veliu, ua ka dorëzuar 36 fermerë llapjanë, pajisjet për ujitjen e plantacioneve me pemë, me sistemin pikë-pikë.

Komuna u dhuroi fermerëve pajisje për sistem të ujitjes së plantacioneve me pemë. Në kuadër të projekteve për subvencionime në sektorin e bujqësisë në komunën e Podujevës, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, u ka shpërndarë 36 fermerëve llapjanë pajisje për ujitjen e plantacioneve të pemëve me sistemin pikë-pikë. Kryetari i Komunës së Podujevës, z.Agim Veliu, gjatë dorëzimit të pajisjeve, ka përgëzuar fermerët përfitues. “Me punën tuaj në krijimin e plantacioneve të pemëve keni treguar se në komunën tonë mund të jetohet mirë edhe nga bujqësia. Ndërsa, për stimulimin e sektorit të bujqësisë, komuna vazhdimisht është duke ndarë buxhet dhe po financon fermerët e të gjitha kategorive. Me këto pajisje për sistemin e ujitjes së plantacioneve të pemëve shpresoj se sado pak do t’ua lehtësojmë punën dhe do të kontribuojmë në rritjen prodhimtarisë”, tha kryetari Veliu, duke premtuar se Komuna do të vazhdojë me subvencionimin e fermerëve.

Fermeri Ramadan Mustafa, nga

Dumnica, i cili ka 4 hektarë plantacione të mbjella me mollë dhe kumbullë, falënderoi Komunën për këtë donacion. “Ky sistem i ujitjes është një ndihmesë për neve dhe një dëshmi e mirë se Komuna po tregon interesim dhe angazhim për stimulimin e sektorit të bujqësisë”, tha Mustafa.

### Mitrovicë: Për 7 muaj përpunohen 37 mijë e 468 lëndë në zyrën e gjendjes civile



Zyra e gjendjes civile në Komunën e Mitrovicës është treguar shumë efikase edhe pas fillimit të zbatimit të programit të ri të gjendjes civile. Si rrjedhojë prej janarit deri në korrik të këtij viti janë përpunuar 37 mijë e 468 lëndë. Shefi i zyrës së gjendjes civile, Afrim Voca, tha se kërkesat më të mëdha kanë qenë për ekstrat të lindjes. “Në këtë periudhë janë lëshuar gjithsej 27 mijë e 554 ekstrakte të lindjes”.

Sipas tij, prej të katër lëndëve 980 janë certifikata të lindjes, 1087 certifikata të martesës, 1507 certifikata vdekjes, 1303 certifikata të vendbanimit, 3213 certifikata të bashkësisë familjare, 945 certifikata të gjendjes martesore, 808 certifikata të shtetësisë dhe 71 vërtetime nga arkiva.

## Shkurtimisht

- 10 korrik 2013 - Përfaqësuesi i AKK-së si anëtar në Komitetin Drejtues të projektit të Komisionit Evropian për përkrahje për regjistrim civil dhe sistemin e adresave, mori pjesë në takimin e komitetit ku u diskutuan çështjet e rëndësishme të cilat kanë qenë në planin e punës për periudhën janar-qershor.
- 11 korrik 2013 - Dy anëtarët e AKK-së, morën pjesë në takimin e radhës së Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare, ku u diskutua Udhëzimi Administrativ për licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare.
- 17 korrik 2013 - Përfaqësuesi i Asociacioni i Komunave të Kosovës si anëtar i Këshillit të Turizmit në Kosovë, mori pjesë në takimin inaugurues të këtij Këshilli. AKK-ja është në mesin e shtatë anëtarëve, që përbëjnë këtë Këshill, i cili do të punojë në promovimin dhe avancimin e turizmit në Kosovë.
- 25 korrik 2013 - AKK-ja prit në takim përfaqësuesit e Bankës Botërore, ku temë e bisedës ishte implementimi i Ligjit të Shërbimit Civil, për tu fokusuar në Sistematizimin e vendeve të punës dhe përshkrimin e vendeve të punës, projekt i cili pritet të fillojë të zbatohet në Kosovë.

# Asociacioni i Komunave të Kosovës

## www.komunat-ks.net



Asociacioni i Komunave të Kosovës  
Association of Kosovo Municipalities  
Asociacija Kosovskih Opština

[Ballina](#) [Për Ne](#) [Kolegjiumet](#) [Publikimet](#) [Partnerët](#) [Lajmet](#) [Linqet](#) [Shpallje](#)

### Meny

- > Dokumentet themelore
- > Aktiviteti Ndërkombëtar
- > Struktura Organizative
- > Komunat e Kosovës
- > Kryetarët e Komunave të Kosovës
- > Auditimi i pasqyrave financiare të AKK-së
- > Ligjet bazike për pushtetin lokal
- > Buxhetet Komunale
- > Zgjedhjet komunale
- > AKK WEB maili

NALAS -- LOGIN



### Këshilli i Kryetarëve debaton pagat e zyrtarëve komunal me Ministrin e Administratës Publike



Asociacioni i Komunave të Kosovës organizoi takimim e rradhës të Këshillit të Kryetarëve, e ku mori pjesë edhe ministri i Ministrisë së Administratës Publike z.Mahir Jaghhillar lidhur me diskutimet për projektligjin për Pagat e Funkionarëve Publik në nivel të Kosovës

### Financat Komunale – Program mësimor për Qeveritë Lokale



Ky kurs do të përmirësojë njohuritë dhe aftësitë e qeverive lokale, veçanërisht në qytetet e mesme dhe të mëdhaja, për financat komunale, duke përfshirë matjen e performancës, menaxhimi i të hyrave dhe të dalave, mjetet dhe shërbimet lokale dhe mobilizimi i burimeve të jashtme

### U mbajt Kuvendi Vjetor i AKK-së



Në praninë e delegatëve dhe të kryetarëve të Komunave, Asociacioni i Komunave të Kosovës ka mbajtur Kuvendin Vjetor për vitin 2013. Kuvendi fillimisht aprovoi Rendin e Ditës si dhe raportin nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Punës së AKK-së

## ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS BULETINI

Viti X. Nr. 61 • Korrik - Gusht 2013

PËRGATITI:

Arsim Osmani - MENAXHER PËR KOMUNIKIM

Tel: 038 245-734; Fax: 038 245-733

E-mail: [info@komunat-ks.net](mailto:info@komunat-ks.net)

Web: [www.komunat-ks.net](http://www.komunat-ks.net)

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës. Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës JugLindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON. Anëtar në pozitën Asociacioni i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR) si dhe anëtar në ALDA (Asociacioni i Agjensive për Demokraci Lokale).

